



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 124, datë 31.07.2024

PËR

**MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË RREGULLOREN NR. 89, DATË 27.06.2016,
“PËR KRITERET DHE KËRKESAT PËR MIRATIMIN E SHOQËRISË AUDITUESE
TË SHOQËRIVE ADMINISTRUESE TË SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE
KOLEKTIVE DHE SHOQËRIVE ADMINISTRUESE TË FONDEVE TË PENSIONIT
VULLNETAR”, E NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar”, e ndryshuar, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Fondeve, për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI

Në rregulloren nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar”, e ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Kudo në rregullore fjalët “ligji nr. 10 197, datë 10.12.2009 “ Për fondet e pensionit vullnetar”” zëvendësohet me fjalët “ligji nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”” si dhe bëhet përditësimi i të gjitha referencave ligjore sipas ligjit nr. 76/2023.
2. Titulli i rregullores “Mbi kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar” ndryshohet “Mbi kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive”.
3. Në fund të nenit 1, shtohen fjalët “...dhe fondeve të administruara prej tyre”.
4. Në nenin 2, fjalët “nenit 33, pika 5, të ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”” zëvendësohet me fjalët “pika 11, e nenit 33, të ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat””.
5. Në pikën 2, të nenit 9, fjalët “...audituesit të jashtëm”, zëvendësohen me fjalët “...shoqërisë audituese”.
6. Në nenin 11, bëhen ndryshimet si më poshtë:
 1. Në pikën 2, fjalët “... të nenit 10 të rregullores nr. 127, datë 06.10.2011 “Mbi përmbajtjen e detyrueshme, afatet dhe formën e raporteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive të administrimit dhe depozitarëve”, e ndryshuar dhe nenit 7, të rregullores nr. 25, datë 23.02.2011 “Për raportimin në AMF të veprimtarisë së shoqërisë administruese të fondeve të pensionit”.” zëvendësohen me fjalët “... nenit 11 të Rregullores nr. 107, datë 30.06.2021 “Mbi përmbajtjen, afatet kohore dhe formën e raporteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive administruese dhe depozitarëve”, dhe nenit 8, të Rregullores nr. __, datë __.__.2024 “Për formën, përmbajtjen dhe afatet kohore të raporteve dhe pasqyrave financiare të ndërmjetme dhe vjetore të shoqërisë administruese, fondit të pensionit privat dhe depozitarit”.
 2. Pika 5, shfuqizohet.